



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M
Nr. 43, date 24.06.2019**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
MËSIMORË NË ARSIMIN PARASHKOLLOR DHE DREJTUESIT NË
INSTITUCIONET PARASHKOLLORË TË QENDRAVE KULTURORE TË
FËMIJËVE DHE KONVIKTEVE TË NXËNËSVE**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 24.6.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, të nenit 51 pika 1, të nenit 54 shkronja “ç”, të nenit 55 pika 2, nenit 71 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 44/2015 datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative”, ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, VKB nr.82, datë 20.12.2018 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2019 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2019-2021 të Bashkisë së Shkodrës" VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr. 191, datë 5.4.2019, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nivelit të pagave të punonjësve mësimorë në arsimin parashkollor dhe drejtuesit në institucionet parashkollorë të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve sipas tabelës nr. 3 bashkëlidhur.
2. Efektet financiare fillojnë me datë 1 prill 2019.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 24.6.2019

Shpallur në datën 26.6.2019

Sekretar i këshillit

K R Y E T A R

Suel Hadri

Xhemal BUSHATI

Pagat e arsimit parashkollor dhe drejtuesit në institucionet parashkollor , të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve

Emërtimi	Arsimi i lartë		Vjetërsia
	Kategoria	Pozicioni	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	51000	2%
Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	44000	2%
Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	42500	2%
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	45000	2%
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	42500	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	1	36650	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	2	34000	2%
Drejtor i konvikteve	1	61000	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	1	39300	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	2	36650	2%